

Fillon Java e Madhe



Pas festimit të Ditës së Dafinave ditën e diel, sot fillon Java e Madhe për të krishterët ortodoksë. Në kushtet e masave të jashtëzakonshme për shkak të Covid-19, me këmbëngulje të Sinodit të Shenjtë **kishat në Bullgari mbeten të hapura** dhe atje do të mbahen shërbesat e zakonshme, por besimtarët duhet të mbajnë një distancë prej 2 metrash dhe të jenë me maska mbrojtëse. **Autoritetet u bënë apel njerëzve për të mos shkuar në tempull**, përveç rasteve të domosdoshmërisë së madhe. Dje mbrëma mjekët nga spitalet e kryeqytetit “Pirogov” dhe nga “Akademia Ushtarake Mjekësore” dolën para spitaleve që të përshëndesin në mënyrë demonstartive njerëzit të cilët mbetën në shtëpi në Festën e Dafinave , duke bërë edhe një herë thirrjen “Jini edhe eju të përgjegjshlm dhe solidarë, mbetuni në shtëpi! Faleminderit!”